



KKPM-2016/03

Në mbështetje të nenit 3, paragrafi 2, pika 6 dhe 11, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve (Ligjit për KPM-në), KPM nxjerr:

KODI I ETIKËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE MEDIALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 1 QËLLIMI

Kodi i Etikës ka për qëllim përcaktimin e rregullave të etikës për Ofritesit e Shërbimeve Mediale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike; në pajtim me parimet etike, standartet e pranuara ndërkombëtarisht dhe respektin ndaj diversitetit të trashëgimisë etnike, kulturore dhe fetare në Republikën e Kosovës; për interesa të sigurisë kombëtare, të integritetit territorial dhe të sigurisë publike; për parandalimin e trazirave dhe të krimít; për mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të njeriut; për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, për mbrojtjen e fëmijëve, për parandalimin e zbulimit të informatave të dhëna në besim dhe për ruajtjen e autoritetit dhe paanësisë.

Neni 2 FUSHËVEPRIMI

Dispozitat e këtij Kodi zbatohen ndaj të gjithë Ofritesve të Shërbimeve Mediale (OSH), të licencuar nga KPM, për të garantuar lirinë e shprehjes, e cila përfshinë të drejtën e shprehjes për dhëni dhe marrjen e informacioneve, mendimeve dhe porosive të tjera pa u penguar dhe duke respektuar parimet e Kushtetutës së Republikës Kosovës, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 3
PËRMBAJTJA E DËMSHME DHE FYESE

1. OSHM-të nuk duhet të transmetojnë ndonjë material që promovon ose nxitë krimin dhe aktivitetet kriminale ose që përmban rrezikun e shkaktimit të dëmit që mund të rezultojë me vdekje, lëndim, dëmtim të pronës apo ndonjë formë tjetër të dhunës.
2. Detajet e një krimi, apo përshkrimi i tij, nuk duhet të paraqiten në mënyrën e cila do të mësonte apo nxiste publikun se si ta bënte atë.
3. OSHM-të sigurohen që materiali i cili mund të shkaktojë dëme, ose përbën shkelje, të justifikohet nga konteksti. Materialet e tillë mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, gjuhën fyeze, dhunën, seksin, dhunën seksuale, poshtërimin, ankthin, shkeljen e dinjitetit njerëzor, trajtimin ose gjuhën diskriminuese. Informacioni i duhur duhet gjithashtu të transmetohet aty ku do të ndihmonte në shbangjen apo minimizimin e shkeljes.

NENI 4
GJUHA VULGARE DHE OFENDUESE

1. OSHM nuk duhet të transmetojnë para kohës së kufizimit (nga ora 24:00 në 05:00) asnjë material që përmban gjuhë vulgare dhe ofenduese.
2. Gjuha vulgare apo ofenduese nuk do të përdoret në programet e dedikuara për fëmijë dhe të mitur, përvèç rasteve më të veçanta të vlerësuara sipas kontekstit.
3. Në programet e drejtpërdrejta (debate/intervista etj), është obligim i OSHM-së që të ndërmarrë veprimet e duhura për evitim e përdorimit të gjuhës vulgare ose ofenduese nga ana e pjesëmarrësve.
4. Gjuha vulgare dhe ofenduese nuk duhet të përdoret në transmetim para kohës së kufizuar (në rastet e televizioneve) apo veçanërisht kur fëmijët ka të ngjarë të jenë duke dëgjuar (në rastet e radiove), përvèç nëse justifikohet nga konteksti.

Neni 5
NXITJA E URREJTJES

1. OSHM-të nuk duhet të nxisin ose promovojnë, qëllimi ose në mënyrë indirekte, cilëndo nga format e diskriminimit dhe jo tolerancës dhe nuk duhet të transmetojnë asnjë material që njollosë një grup etnik apo fetar, apo që nënkupton se një grup etnik apo fetarë është përgjegjës për aktivitete kriminale.
2. Raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose tjetër; prejardhja kombëtare a shoqërore; lidhja me ndonjë komunitet; prona; orientimi seksual, ekonomik dhe shoqëror;

Page 2 of 7

lindja, aftësia e kufizuar apo çfarëdo statusi tjetër personal nuk duhet të përdoret në atë mënyrë që individët të vihen në pozitë denigruese, të pafavorshme, të përqeshen apo tallen.

3. OSHM-të gjatë transmetimit të përmbajtjes nuk do të lejojnë përdorimin e shprehjeve gjuhësore denigruese, me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupei në bazë të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, gjendjes martesore, moshës apo paaftësisë fizike apo mendore.
4. OSHM-të do të sigurohen që të përdorin terminologjinë adekuate, të përshtatshme dhe të pranueshme për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara.
5. OSHM-të nuk duhet të transmetojnë përmbajtje programore që nxisin urrejtjen dhe pabarazinë dhe që mund të rezultojnë me veprime kriminale ose të dhunshme kundër një individi apo grupei.
6. OSHM-të nuk duhet të transmetojnë përmbajtje programore që nxisin urrejtjen mbi bazat e përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, gjendjes martesore, orientimit seksual, moshës, paaftësisë fizike apo mendore, pavarësisht nga situata apo rrëthanat.
7. Referimet rreth përkatësisë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose tjetër, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal mund të bëhen vetëm në rastet kur ky informacion është me rëndësi të drejtpërdrejt për ngjarjen për të cilën raportohet.
8. OSHM-të nuk do të transmetojnë përmbajtje programore që nxisin trazira apo rebelim.

Neni 6 PAANSHMËRIA DHE SAKTËSIA E LAJMIT

1. OSHM-të duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t'i paraqesin ato në mënyrë të paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë material për të cilin e dinë ose duhet të dinë se është i pavërtetë ose mashtrues.
2. OSHM-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërthënieve politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnje privilegji për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ.
3. OSHM-të do të marrin të gjitha masat e duhura për të mbrojtur pavarësinë e gazetarëve të tyre nga ndikimi politik dhe ekonomik, përfshirë edhe nga pronarët e mediave. Ata informojnë KPM-në për masat e miratuara për këtë qëllim.

4. Përderisa OSHM-të janë të lirë për të shprehur opinionet e tyre, ata duhet të bëjnë dallimin e qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit. Lajmi është informacion i përbërë nga faktet dhe të dhënat, ndërsa opinioni mbart mendimet, idetë, besimet, supozimet, komentet apo gjykimet vlerësuese.
5. OSHM-të e kanë obligim profesional që menjëherë të korrigojnë çfarëdo informacioni të publikuar që është gjetur të jetë i pasaktë dhe të pranojnë gabimin e tyre. Korrigimet duhet të planifikohen në mënyrë të përshtatshme.
6. OSHM-të nuk duhet të bëjnë plagjiaturë dhe duhet të tregojnë burimin e informacionit që është publikuar diku tjetër.
7. OSHM-të duhet të ofrojnë prezantim të perspektivave të ndryshme në mënyre korakte dhe të drejtë. Në qoftë se njëra palë refuzon që të ofrojë pikëpamjen e saj, publiku duhet të informohet për këtë refuzim.
8. OSHM-të duhet të bazohen në burime të identifikuashme të informacionit dhe duhet të janë të përkushtuar për të mbrojtur identitetin e atyre që japid informacion në besim, pa marrë parasysh se a kërkohet kjo paraprakisht apo jo.
9. Asnjë politikan nuk mund të angazhohet si moderator lajmësh, intervistues apo reporter në ndonjë program të lajmeve.

Neni 7 TË DREJTAT INDIVIDUALE

1. E drejta e privatësisë së individuve duhet të respektohet. Ndërhyrja në çështjet thjeshtë private apo personale të cilat nuk kanë ndikim në interesin publik është e ndaluar. Ata që janë prekur nga tragjedia apo pikëllimi duhet të trajtohen me ndjeshmëri, respekt dhe maturi duke e respektuar privatësinë e plotë të tyre.
2. OSHM-të respekojnë të drejtën e individit që të konsiderohet i pafajshëm derisa të mos vërtetohet fajësia nga gjykata kompetente.
3. OSHM-të nuk duhet të transmetojnë materiale që identifikojnë personat e arrestuar apo ndaluar që sulmohen fizikisht apo verbalisht në mënyrë që i përul apo poshteron ata.
4. Bisedat ose intervistat telefonike nuk duhet të transmetohen pa e njoftuar palën tjetër paraprakisht, përveç kur është fjala për interesin publik.
5. Sulmet personale, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në sulmet në ndershmërinë, integritetin apo cilësinë personale të një personi, institucioni apo grupei të identifikuar, në çështje që nuk kanë të bëjnë me interesin publik, janë të ndaluara.
6. Programet që kanë qëllim të keq, përmbajnë kriticizëm të padrejtë apo sulm në një person fizik apo juridik, janë të ndaluara.

Page 4 of 7

7. Kur transmetohen sulmet personale ndaj ndonjë personi, institucioni apo grapi, atij personi, institucioni apo grapi duhet t'i jepet një mundësi e drejtë për t'u përgjigjur menjëherë në të njëjtin program, nëse është e mundur, ose në rastin e parë të mundshëm. Nëse nuk mund të bëhet në këtë mënyrë, mundësia për t'u përgjigjur duhet t'i jepet në ndonjë program tjeter nën kushte të ngashme.
8. Rrëfimet për tragjeditë personale duhet të paraqiten me kujdes dhe mirëkuptim nga ana e OSHM-ve.

Neni 8 PROGRAMET FETARE

1. OSHM-të duhet të ushtrojnë shkallën e duhur të përgjegjësisë në programet me përbajtje fetare.
2. Pikëpamjet fetare dhe besimet e atyre që i përkasin një religjioni të caktuar, apo emërtimi fetar të veçantë, nuk duhen të janë subjekt i trajtimit abuziv.
3. Kur një religjion apo emërtim fetar është temë diskutimi ose një nga temat e diskutimit në një program religjioz, atëherë identiteti i religionit dhe emërtimi duhet jetë i qartë për publikun.

Neni 9 PARAQITJA DHE PËRFSHIRJA E FËMIJËVE DHE TË MITURVE NË PROGRAMET E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE

1. E drejta e privatësisë së fëmijëve duhet të respektohet gjithmonë. Pasi që publiciteti i panevojshëm apo etiketimi i gabuar mund t'i dëmtojë ata, fëmijët dhe të miturit që janë viktima të abuzimit apo në konflikt me ligjin nuk duhet të identifikojen, drejtpërdrejt apo tërthortë. Nuk duhet të transmetohet asnjë informacion që mund t'i identifikojë ata.
2. Befasitë apo intervistat e paplanifikuara (“pritat”) të fëmijëve dhe të miturve janë të ndaluara.
3. Fëmijët dhe të miturit viktima, të dyshuar, të akuzuar për ndonjë krim, të arrestuar apo ndaluar nën dyshimin për keqbërje, si edhe fëmijët dhe të miturit që janë duke kaluar nëpër një proces gjyqësor, duhet të mbrohen nga vuajtjet tjera, shqetësimi apo traumat; ata duhet të intervistohen vetëm me miratim të prindërve të tyre apo kujdestarit ligjor, përvèç nëse prindi apo kujdestari është i akuzuar. Intervista duhet të bëhet vetëm me autoritet dhe mbikëqyrje të avokatëve, psikologëve apo punëtorëve social të kualifikuar, përgjegjës për mirëqenien e tyre.

4. Nga fëmijët dhe të miturit nuk duhet të kërcohët të detyrohen apo të korruptohen për t'i kujtuar dhe treguar përvojat traumatike, të demonstrojnë aktet e tmerrshme apo t'i përshkruajnë ato në detaje grafike.
5. OSHM-të nuk duhet të transmetojnë intervista apo fotografi të fëmijëve nën moshën 14 vjeç në lidhje me çështje që janë të ndërlidhura me familjet e tyre, pa pëlqimin paraprak të prindit apo një të rrituri që është përgjegjës për fëmijën.
6. OSHM-të nuk duhet të identifikojnë fëmijët, nën moshën 14 vjeç, të cilët janë të përfshirë në vepra penale, qoftë si dëshmitarë apo të pandehur.
7. Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.
8. OSHM-të duhet të kujdesen për mirëqenien fizike, emocionale dhe dinjitetin e të miturve (nën moshën 18 vjeç) të cilët marrin pjesë në program apo janë të përfshirë në ndonjë mënyrë tjetër. Kjo vlen pavarësisht pëlqimit paraprak nga një prind apo një i rritur i cili është përgjegjës për të miturin.
9. OSHM-të duhet të sigurojnë që shpërblimet e dedikuara për fëmijët të janë të përshtatshme për moshën e pjesëmarrësve në program dhe për grupin e synuar nga programi.

Neni 10 E DREJTA PËR PËRGJIGJE

1. Me qëllim të korrektësisë dhe paanshmërisë duhet të ofrohet mundësia që brenda shtatë (7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetohet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë të njëjtë.
2. Çdo person, pa dallim shtetësie ose vendbanimi, që përmendet në një ofrues të shërbimit medial për të cilin faktet janë bërë të disponueshme për publikun të cilat ai i deklaron që janë të pasakta, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit për të korriguar faktet që shqetësojnë atë person.
3. OSHM-të janë të obliguar që kërkesën për reagim ta shqyrtojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

Neni 11 SANKSIONET

1. Shkeljet eventuale të dispozitave të këtij Kodi do të procedohen dhe sanksionohen sipas Ligjit të KPM-së.

2. Në raste të veçanta, kur një OSHM përmes programit të vet nxit veprime që cenojnë interesin nacional dhe sigurinë e përgjithshme, KPM do të urdhërojë OSHM-në që menjëherë ta ndërpres transmetimin e përbajtjeve të tilla. Transmetimi i përbajtjeve të tilla mund të rezultojë më ndërprerje të licencës së OSHM-së, në pajtim me Ligjin e KPM-së.

Neni 12
DISPOZITAT KALIMTARE

Më hyrjen në fuqi të këtij Kodi shfuqizohet Kodi i Sjelljes për Shërbimet Mediale Audiovizuale në Republikën e Kosovës KKPM-2010/01.

Neni 13
HYRJA NË FUQI

Ky Kod hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Adnan MEROVCI



Kryetar i Komisionit të Pavarur të Mediave



Data:

11.10.2016